

FLORIANA PANGO

**VËSHTRIM KRAHASUES MBI FRAZELOGJINË ME EMRA
PEMËSH E LULESH NË GJUHËN SHQIPE DHE ITALIANE**

Bota shpirtërore e çdo populli gjen format e saj të shprehjes edhe në gjuhë. Shprehjet frazeologjike janë dëshmi e këtij botëkuptimi dhe na japin një panoramë të detajuar të zhvillimeve socio dhe etnolinguistike të popullit. Koncepti i njësisë frazeologjike edhe pse në këto dy gjuhë trajtohet me emërtime të ndryshme paraqitet i gjallë, shumëngjyrësh dhe tepër dinamik. Sipas një vështrimi diakronik shumë njësi frazeologjike kanë pësuar transformime, të tjera rezultojnë pak të përdorura vitet e fundit dhe akoma shumë të tjera kanë lindur si rezultat i zhvillimeve që kanë përfshirë këto dy vende. Gjuha shqipe dhe gjuha italiane si gjuhë të dy popujve shumë të afërt gjeografikisht paraqiten me forma sa të ngjashme aq edhe të ndryshme gjatë krijimit, përdorimit dhe peshës semantike të shprehjeve frazeologjike.

Në bazë të përkufizimeve pranohet dhe argumentohet se njësia ***frazeologjike është formuar nga shndërrimi figurativ i një togfjalëshi të lirë*** dhe si tipare të përgjithshme të njësisë frazeologjike në literaturën shqipe janë njohur:

- *struktura togfjalëshore,*
- *njësia kuptimore,*
- *qëndrueshmëria,*
- *figურshmëria,*
- *neutralizimi i raporteve të brendshme sintaksore,*
- *njëvlefshmëria me fjalën nga ana e kuptimit kategorial dhe e funksionit në ligjërim.*¹

Duke iu referuar përkufizimeve të dhëna nga leksikografët për frazeologjinë italiane, mund të themi se tiparet janë pothuajse të njëjta pra:

- *tërësi lemash,*
- *tërësi kuptimore konvecionale,*
- *njëvlefshmëria me fjalën,*
- *njësi komunikimi,*
- *kuptimi i saj nuk është shumë e kuptimeve të gjymtyrëve përbërëse*².

Në studimet bashkëkohore në literaturën italiane mbi njësinë frazeologjike dhe frazeografinë, gjejmë disa emërtime të reja për frazeologjinë si: *kod paremiak* (shprehje të figurshme idiomatike), *formulë paremiake*, *shenjë*

¹ J. Thomaj, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.

² C. Lapucci, *Il dizionario dei modi di dire della lingua italiana*, Garzanti, 1993.

retorike (metafora, hiperbola, alegoria dhe personifikimi), kod retorik, të cilat të gjitha kanë të bëjnë me pasurinë demologjike, si një nënsistem i saj i veçantë.

Krahas shprehjeve frazeologjike – idiomatike (sekuenca sintaksore kuptimi tërësor i të cilave ndryshon nga shuma e kuptimeve të elementëve të vetëm, ndeshim çdo ditë në ato që quhen *shprehje didaktike* (në italisht të quajtura edhe *adagio*)³, të cilat rekomandojnë apo këshillojnë, të ndërtuara në formë vargësh me strukturë përgjithësisht proverbiale si: *gusht e gunë – vjeshtë e lugë; hëngre fikun – vish leshnikun; vishet mani – zhvishet isani; ferra e nisi, ferra e grisi; është yll e është hënë, është mollë për të ngrënë*. Apo në italisht: *manica a dritto – corpo a rovescio; seminato rado – frumento fito; mai seminare in crescere di luna; nebbia bassa – bel tempo lascia* etj.

Frazeologjia shqiptare i ka përcaktuar teorikisht dhe praktikisht njësitë e saj leksiko-semantike themelore.⁴ E pikërisht nga kjo pikëpamje kemi përsëri ngjashmëri midis dy frazeologjive. Mund të dallojmë këtu se të dyja gjuhët kanë një ndarje si vijon:

a) Njësi frazeologjike sipas vlerës leksiko – gramatikore

1) **Njësi frazeologjike me vlerë emërore:** *dal frutto si conosce l'albero – pema njihet nga kokrrat; il fior degli anni – në lule e rinisë; non c'è rosa senza spine – s'ka trëndafil pa gjemba – s'ka pyll pa derra* etj.

Në këtë grup njësisht frazeologjike, në të dyja gjuhët, vërejmë se emërtimet frazeologjike bimëve dhe kafshëve përdoren zakonisht në trajtën e pashquar.⁵

2) **Njësitë frazeologjike me vlerë mbiemërore:** *pel di carota – qimekuq; testa di zucca – kokëkungull; zucca dura – kokëfortë; essere la più bella rosa del giardino – më e bukura e shoqeve – është yll e është hënë, është mollë për të ngrënë; Èshtë bërë trëndelinë – u varfërua shumë* etj.

3) **Njësi frazeologjike me vlerë foljore:** *dormire sugli allori – fle mbi dafina; raccogliere broccoli; piantar carote – t'i shet goglat për arra; avere la castagna; prendere in castagna – zë me presh në duar; avere un cocomero in corpo; non tenere un cocomero all'erta – s'i mban goja arra; piantare un melo – e zuri peshkun / zogun; avere la faccia tonda (rossa) come una mela – faqekuq si molla, ka ngrënë lule thane; essere tutto rose e fiori – mjalt e gjalp; riprendere datteri per fichi – i marr hurmat për fiq; lasciar le pere in guardia all'orso – bëj ukjun bari* etj.

Të shumta janë njësitë frazeologjike me strukturë fjalie e sidomos me pjesëzën krahasuese si. Të tilla janë:

- *Crescere come i funghi – mbijnë si kërpudhat;*

³ P. Bessi, *Le strutture del proverbio monofrastico*, Orso, 2004.

⁴ Xh. Lloshi, *Mbi studimin e veçorive stilistike të shqipes*, SF 1970/1, f. 31-50.

⁵ Z. Gjoçaj, *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë, 2001.

Vështrim krahasues mbi frazeologjinë me emra pemësh e lulesh...

- *Cadere come una pera cotta* – bie si fiku nga pema;
- *Spremere come un limone* – e shtrydh si limoni
- *Essere rosso come un papavero* – të jesh i kuq si spec
- *Fare come la volpe con l'uva* – si dhelpra dhe rrushtë etj.

b) Nga pikëpamja semantike klasifikimi i njësive frazeologjike kryhet duke u bazuar mbi motivimin dhe ndahen në:

1) **Njësi të motivueshme:** janë lokucione të përdorura si sintagma të lira: *lavarsi le mani, tirare l'acqua nel proprio mulino, tenere il coltello per il manico, prendere il toro per le corna; i vuri zjarrin, hidhte baltë, i dha armët, e zgjidhi qesen* etj.

2) **Njësi pjesërisht të motivueshme:** këtu bëjnë pjesë të gjitha ato shprehje ku një element është me kuptim të figurshëm: *avere la faccia di bronzo*. Këtu *bronzo* është përdorur me kuptim të figurshëm; *fare un bucco nell'acqua* – *bucco* është përdorur me kuptim të figurshëm; *dare la polvere negli occhi* – *polvere*, etj.

3) **Njësi të pamotivueshme:** *cavallo di Friscia / mandare in Carfanao, Essere il parere di Perpetua, valere un Peru'*, bëri emër, bëri ballë, shet mend etj.

Këto lokucione kanë një vlerë të madhe stilistike sepse specifikojnë veprime. Dihet që motivimi i njësive frazeologjike ka rëndësi të veçantë për zbulimin e plotë të kuptimit të tyre, për gjetjen e burimit (formal e semantik), për shpjegimin e shumë lëvizjeve kuptimore dhe të ndryshimeve strukturore, për njohjen e truallit gjuhësor të formimit etj. Në shumë drejtime motivimi i njësive frazeologjike lidhet me historinë e formimit dhe të zhvillimit të tyre, si dhe me gjurmimin etimologjik. Kështu, veç faktorëve gjuhësorë, ndikojnë edhe faktorët jashtëgjuhësorë (historiko-shoqëror, etnografik etj.).

c) Nga pikëpamja etimologjike është interesante të konsultohen burimet nga ku rrjedhin këto lokucione.

Frazeologjia është si një muze fjalësh e formash të huaja, kombëtare, arkaike, krahinore, gjuhësore të shkruara në një tërësi leksiko-gramatikore.⁶ Tashmë njësitë frazeologjike janë të vjetra po aq sa leksiku i gjuhës e megjithatë vazhdojnë përpjekjet për të zbuluar historikun apo burimin nga ku kanë marrë jetë këto njësi. Në një hulumtim në disa fjalorë të gjuhës shqipe dhe italiane kemi vërejtur se disa nga burimet ishin të njëjta. Ndër to po përmendim:

- **Shkrimet e Shenjta, Ungjilli:** Në çdo komunitet shkrimet e shenjta, përveç vlerave fetare dhe shpirtërore, kanë edhe atë të termit të ballafaqimit mbi të cilën duhet të modelohet apo gjykohet jeta. *Mandare da Erode a Pilato; Essere un calvario; Dare a Cesare quel che e' di Cesare; Non essere*

⁶ Z. Gjoçaj, *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë, 2001.

degno di legare i calzari; Passare all'ossanna al crucifige; Passare dalle stelle alle stalle; Essere un ecce uomo; dare il bacio di Giuda; Lavarsene le mani; Essere un sepolcro imbiancato; Non resta pitra su pietra; Rri si Shën Mëri; Prish agjërimin; pastroj ahuret e Augjisë; Barku i Shën Mërisë; është delja e zezë; e mori ferra uratën; kreshmë pas Pashke etj.

- **Fabulat:** në veçanti nga ato të Ezopit, të cilave iu shtohen ato të Fedros, Avianos, La Fontenit dhe ato të autorëve të ndryshëm klasikë: *Fare il parto della montagna; essere il re travicello; Fare le parti del leone; Fare come la volpe con l'uva; Gonfiarsi come la rana; Scaldare il serpe nel seno; Dare il calcio dell'asino; Essere un vaso di coccia accanto un vaso di ferro; farsi bello con le penne del pavone; Vendere la pelle dell'orso prima di averlo ucciso; vajt si breshka te nallbani; rrit gjarprin në gji etj.*

- Lokucione proverbiale që lidhen me **mitologjinë klasike, popujt** etj. Në gjuhën italiane kanë vërshuar elementë të kulturës greke dhe latine, duke sjellë paradigma të shumta mitologjike: *Avere il tallone d'Achille, fare l'indiano; fumare come un turco; Ka dava Janina; fitorja e Pirros; pëlhura e Penelopës; dhëntë e dhitë e Zeres, nami i Kapllan Qeres; plasi Muçoja për dufek; do dhe Muçoja kafe; Si rrushi e koshi – si Ruçua dhe Muçua; i bëhet ferra Brahim; avazi i Mukës; që në kohë të baba Qemos; puthu me Milon; u zunë për mustaqet e Çelos; për një koskë deri në Poloskë; shkon në Berat për një masat; nuk ka mjekër për Qabe; harro mushkë Valarenë; ka gjetur Amerikën; kalë Troje; opingat e Sheros; hiç po Habili; i flet si evgjiti të shoqes; jemi bërë si arixhinj (jemi bërë top i marrë) etj.*

- Disa idioma janë të lidhura me **kafshët, pemët, lulet** etj., të cilat kanë pasur gjithmonë në jetën e njeriut një rëndësi të madhe dhe si pasojë përdorimi i tyre në mënyrë metaforike sigurisht që nuk është rastësi: *fare la civetta; prendere il toro per la corna; versare larime di coccodrillo; arrë gungë; i bën dushku arra; i pjell edhe mushka; ia bëri bletë; mbjell bostan e dalin kastraveca; shkojnë si fiku me arrën; E ka grurë me dikë; U bë rrap e rrënjë; Sharton thanën me shegën; Ra vaji në lakra etj.*

Do të ishte interesante të paraqisnim edhe disa nga shprehjet e sipërpërmendura së bashku me simotrat e tyre në gjuhën shqipe. Jo domosdoshmërisht kanë elemente të njëjta brenda strukturës frazeologjike. Pra nëse marrim në shqyrtim njësitë frazeologjike me emra lulesh, pemësh e bimësh nuk mund të pretendojmë se të njëjtë do jenë edhe në gjuhën shqipe sepse siç dihet tashmë, sfera etimologjike e tyre varet nga traditat, historia apo veçantitë e secilit popull. Nëse do të bënim një përkthim të fjalëpërfjalshëm, do të dilnim nga kornizat e frazeologjisë. Po japim disa shembuj si vijon:

- Essere tutto rose e fiore – të jesh mjaltë e gjalpë me dikë/ ta kesh grurë me dikë (të shkosh mirë)
- Essere giallo come un limone – u bë limon (ftua, lulekungulli) (u zbeh)

Vështrim krahasues mbi frazeologjinë me emra pemësh e lulesh...

- Aver la faccia tonda (rossa) come una mela - Ka ngrënë lule thanë (i shëndetshëm)
- Piantare un melo – kapi peshkun (u rrëzua)
- Essere due anime in un nocciolo – shkojnë si arra me fikun (shkojnë shumë mirë)
- Essere rosso come un papavero – paparun i kuq
- Diventar rosso come un peperone – u skuq si spec
- Essere un discorso fatto a pera – një punë e bërë me këmbë, shkel e shko
- Dar (avere) le pere – i dha duart
- Avere il prezzemolo negli orecchi – e kanë lënë veshët
- Essere più vecchio del prezzemolo – u bë rrap e rrënjë
- Essere come il prezzemolo – farë kungulli (hithre) (mbiu si farë e keqe)
- Pigliare due rigogoli a un fico – me një gur vret dy zogj
- Fare come la volpe con l'uva – si dhelpra dhe rrushtë
- Piantar carote - T'i shet goglat për arra

Si përfundim mund të themi se të shumta janë përdorimet metaforike, në këtë rast përdorimi i njësive frazeologjike, të cilat kanë ardhur të trashëguara brez pas brezi, janë bërë pjesë e ligjërimit tonë të përditshme dhe ne i përdorim pa u menduar. Në këtë pasuri gjuhësore gjendet e pasqyruar historia, urtia, jeta dhe bota e popullit. Falë studimeve demologjike dhe parmeologjike, ne sot mund të shfletojmë këtë pasuri ndërkombëtare. Duke u mbështetur në këto vjelje arrijmë të shohim ngjashmëritë dhe diferencat që mund të ekzistojnë në një përjasje të parë midis frazeologjive të dy popujve. Por nga ana tjetër vërejmë se si pasojë e ndërkëmbimeve kulturore kemi edhe huazime të disa njësive frazeologjike për të cilat do të ndalemi në një moment tjetër.

BIBLIOGRAFI

- Artan Fida, *Fjalor frazeologjik italisht shqip*, Tiranë, 1998.
C. Lapucci, *Il dizionario dei modi di dire della lingua italiana*, Garzanti, 1993.
J. Thomaj, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.
J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë në gjuhën shqipe*, 1985.
Naim Balla – Eshref Ymeri, *Fjalor frazeologjik italisht – shqip*.
P. Bessi, *Le strutture del proverbio monofrastico*, Orso, 2004.
Xh. Lloshi, *Mbi studimin e veçorive stilistike të shqipes*, SF 1970/1.
Z. Gjoçaj, *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë, 2001.
Zingarelli, *Vocabolario di lingua italiana*, 2000.

